



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 631/18

PANELI SHQYRTUES i emëruar nga kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues dhe z. Blerim Dina – anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt:20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, /KK-Prishtinë/ të datës: 22.06.2018, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, përkitazi me operatorin ekonomik “NTSH.Migrant Ing” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pajisje elektrike dhe mekanike”, me nr. prok: 616-18-3046-121, më dt. 29.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) / KK-Prishtinë /e dt: 22.06.2018, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “NTSH. "Migrant Ing" – Prishtinë lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje elektrike dhe mekanike”, me nr. prok: 616-18-3046-121.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues /KK-Prishtinë/ me dt:22.06.2018, ka parashtuar kërkesë që OSHP konform kompetencave që ka të veprojë konform nenit 99.2 të LPP-së dhe të bëjë diskualifikimin e Operatorit Ekonomik NTSH. "Migrant Ing" – Prishtinë, nga pjesëmarrja në prokurimin publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 98.2, të LPP-së me datë: 26.06.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të përgatitur një kronologji në lidhje me këtë kërkesë.

Eksperti shqyrtues me dt:09.07.2018 ka dorëzuar kronologjinë ku ka sqaruar se në bazë të shkresave që kemi në posedim, ju njoftojmë shkurtimisht me kërkesën e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të pranuar në OSHP me datën 26.06.2018, për diskualifikim nga proceset e prokurimit të Operatorit Ekonomik "Migrant Ing"-Prishtinë.

AK – Komuna e Prishtinës, sipas përshkrimit në kërkesës me datën 07.05.2018 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje elektronike, elektrike dhe mekanik", me nr. prok. 616-18-3046-1-2-1 dhe sipas rezultateve të vlerësimit për kontratë për llot I dhe II e propozon OE."Migrant Ing"

Pas rekomandimit për kontratë Komuna e Prishtinës me datë 13.06.2018 përmes shkresës elektronike e njofton OE "Migrant Ing " për sjelljen dokumenteve të parapara sipas nenit III.1.2 të dosjes së tenderit konkretisht dëshminë nga ATK për kryerjen e obligimeve dhe Vërtetimin Gjykatës .

OE "Migrant Ing" me datë 19.06.2018 e njofton AK-në , se Vërtetimin nga ATK nuk mund të sjell për shkak se ka obligime të pa paguara ndaj ATK-së, dhe në bazë të kësaj Komuna Prishtinës përmes shkresës i drejtohet OSHP-së për diskualifikim të OE."Migrant Ing" nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë një (1) vjeçare.

Kërkesa për diskualifikim i referohet nenit 99. pika 2 të LPP-së sipas e cilit nën OSHP ka autoritetin të shqyrtoj kërkesat dhe të diskualifikoj OE për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit për një periudhë një (1) vjeçare.

Gjithashtu AK është thirrur në nenin 26.8 të UOPP në bazë të cilit përcaktohen përgjegjësit e OE lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë

Sipas shkresës AK pas dështimit të sjelljes së dëshmi lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë nga ana e OE" Migrant Ing" ka vazhduar për kontratë me OE dytë me radhë dhe njëkohësisht ka iniciuar procedurën në OSHP për diskualifikim të OE "Migrant Ing".

Gjithashtu sipas shkrese AK nuk ka mundësi tjera ndëshkimore pasi në dosje të tenderit nuk është kërkuar sigurimi i ofertës

Si dëshmi me kërkesën për diskualifikim AK ka sjell:

- Kërkesën për diskualifikim
- Korrespondencat mes OE "Migrant-Ing" dhe Autoritetit kontraktues-Komuna Prishtinës dhe
- Njoftimin për kontratë.

Në seancën dëgjimore e cila është mbajtur me dt:29.08.2018, kanë marr pjesë paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues si dhe përfaqësuesi i AK-së, ndërsa përfaqësuesi i OE NTSH. "Migrant Ing" – Prishtinë, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka marr pjesë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj.Jashari deklaroj: AK-KK Prishtinë pasi ka shpall tenderin për furnizim me pajisje elektronike elektrike dhe mekanike, pasi kanë dorëzuar ofertat OE-të, komisioni vlerësues e ka propozuar për dhënie OE Migrant për lotët 1 dhe 2. Pastaj kemi ftuar OE të sjell dokumentin e ATK dhe Gjykatës përmes emalit, mirëpo nuk është përgjigjur fare dhe kemi thithur për mes telefonit që të sjell dokumentet dhe në përgjigje ka thënë se nuk mundet ti sjell pasi ka borxhe ndaj ATK. Derisa ka nënshkruar deklaratën nën betim OE atëherë vlerësojmë se ka vënë në lajthitje AK-në.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z.Hyseni deklaroj: Ne si OE kemi nënshkruar deklaratën nën betim, mirëpo pas paraqitjes së disa problemeve me një kontratë në KK Ranillug gjegjësisht kryerjen e pagesave, atëherë jemi vonuar me pagesën e deklaratën vjetore tatimore. Ne jemi vonuar në sjelljen e dokumentit për këtë arsye dhe me vete kemi deklaratën për borxhin e papaguar – pagesën e vonuar nga ATK e datës 05.06.2018.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Sheqiri deklaroj: Tani më veç dihet arsyeja e kërkesës së AK-së. Si ekspert i prokurimit nuk mendoj se për këtë arsye të futet në listë të zezë pasi në situatë të tillë kompanitë mund të gjenden në çdo moment. E mira është se AK nuk ka dështuar në realizimin e aktivitetit të prokurimit dhe i mbetet panelit të vlerësoj më tutje.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK ankues znj.Jashari deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj kërkesën e AK-së si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE fitues z.Morina deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të refuzoj kërkesën e AK-së si të pabazuar.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk ka ofruar dëshmi se operatori ekonomik "NTSH.Migrant Ing" - Prishtinë ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues në mungesë të dëshmive dhe argumenteve se operatori ekonomik "NTSH.Migrant Ing" - Prishtinë ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme, vjen në përfundim se kërkesa e AK-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të operatorit ekonomik "NTSH.Migrant Ing" - Prishtinë është e pabazuar dhe e pa mbështetur në fakte dhe argumente konkrete dhe se kërkesa e autoritetit kontraktues nuk hynë në kuadër të kompetencave të OSHP-së, të parashikuara në nenin 99.2 të LPP.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – KK-Prishtinë
- 1x1 OE NTSH. "Migrant Ing" - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran MILENKOVIC

